

## LIGJ

Nr. 49/2013

### PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9636, DATË 6.11.2006 "PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## KUVENDI

### I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

#### Neni 1

Në të gjithë ligjin, emërtimi "Policia Tatimore" zëvendësohet me emërtimin "Organet tatimore".

#### Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. "Mjedis publik" është çdo mjedis i hapur për publikun."

2. Në fund të pikës 13, fjalët "që frekuentohet gjatë orarit të punës" hiqen.

3. Pas pikës 17 shtohet pika 18 me këtë përmbajtje: "18. "Mjedis i mbyllur" është:

a) një mjedis që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar plotësisht me mure të përherëshme ose të përkohshme;

b) një mjedis, që ka tavan ose çati, dyer, dritare ose rrugëkalime që mund të jenë të hapura apo të mbyllura dhe është i kufizuar me mure të përherëshme ose të përkohshme, muret e të cilit kanë hapje të përherëshme, që nuk mund të hapen apo të mbyllen, me sipërfaqe më pak se 50 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të mureve."

#### Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalës "paralajmëruese" shtohen fjalët "në tekst dhe/ose në figurë".
2. Në paragrafin e fundit, fjala "teksti" zëvendësohet me fjalën "përmbajtje".

Neni 4

Në nenin 15, shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë: "dh) Mjedise të tjera publike të mbyllura.".

Neni 5

Në fund të nenit 16 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

"Forma dhe teksti i shenjave paralajmëruese përcaktohen nga KNMSHPD-ja.".

Neni 6

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Emërtimi "Inspektorati Sanitar Shtetëror" zëvendësohet me emërtimin "Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit".
2. Pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Organet e kontrollit, sipas përcaktimit të këtij neni, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"."

Neni 7

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat "c" dhe "ë" ndryshohen si më poshtë:

"c) shkelja e nenit 10 dënohet me konfiskim të produkteve të duhanit dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë, sipas rastit, subjektit shitës me pakicë ose pronar i veprimtarisë së parashikuar;

ë) mospërmbushja e detyrimeve të parashikuara në nenet 15 dhe 16 nga pronari/administratori apo personi i caktuar përgjegjës prej tyre dënohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë për pronarin/administratorin e mjediseve apo personin e caktuar prej tyre.".

2. Pas shkronjës "ë" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Masa e konfiskimit dhe asgjësimit janë dënime kryesore, ndërsa masa e gjobës është dënim kryesor kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues kur jepet njëkohësisht me masën e konfiskimit ose asgjësimit.".

3. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Ankimi ndaj vendimeve të inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin, ndërsa ankimi ndaj organeve tatimore, doganore, Policisë Bashkiake ose të komunës bëhet sipas legjislacionit në fuqi."

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 8008, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani